



---

## KONFERENCA RAJONALE

### **GRATË NË VENDIM-MARRJE NE NIVEL LOKAL / ROLI I GRAVE KRYETARE SI FAKTOR POTENCIAL TË NDRYSHIMIT**

-----  
*Organizuar nga Lobi Rajonal i Grave për  
Paqe, Siguri dhe Drejtësi në Evropën Juglindore / LRG EJL dhe UN Women*

*Data: 7 Nëntor 2016 / Vendi: Tetovë, Maqedoni*

.....

## KONCEPT DOKUMENTI

**"Ne nuk mund të përjashtojmë gjysmën e njerëzimit nga vendim-marrja politike."  
Anne Hidalgo, Kryetare e Paris-it.**

### **Historiku dhe arsytimi**

UN WOMEN është një faktor kyç në promovimin e rolit të gruas në krijim të paqes, dhe përpjekjet për ruajtje dhe ndërtim të paqes. Që nga miratimi i rezolutës UNSCR 1325 (200), UN Women ka kaluar gratë përmbi ndarjet etnike dhe ka mbështetur përpjekje të ndryshme për paqe dhe siguri, dhe ka zhvilluar programe dhe projekte që fokusohen në rritjen e pjesëmarrjes së grave në vendim-marrje dhe procese të paqes, duke promovuar perspektivën gjinore në zhvillim të politikave, forcuar mbrojtjen e grave të prekura nga konflikti, luftuar kundër dhunës seksuale të lidhur me konflikte, ekstremizmin e dhunës, duke amplifikuar thirrjet për llogaridhënie dhe avancuar statusin e grave në mjediset post-konflikteve.

Një prej organeve më të shquara në nivel rajonal, që jo vetëm ka lobuar dhe avokuar për pjesëmarrjen e grave në politikë dhe vendim-marrje, por edhe për përfshirjen e grave dhe perspektivës së grave në proceset e ndërtimit të paqes, është Lobi Rajonal i Grave për Paqe, Drejtësi dhe Siguri në Evropën Juglindore (LRG EJL). Me UN WOMEN si forcën lëvizëse, LRG EJL për herë të parë u shfaq në vitin 2006 në mjedisin kompleks dhe sfidues pas-konfliktit në BP. LRG EJL bashkon gra politikane të nivelit të lartë dhe përfaqësuese të shoqërisë civile nga Shqipëria, B dhe H, Kroacia, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia, që janë të dedikuara për të thyer barrierat e politikës etno-centrike dhe promovuar të drejtat e grave, në veçanti në lidhje me pjesëmarrjen e grave në vendim-marrje dhe në proceset e ndërtimit të paqes. LRG EJL gëzon një reputacion shumë të vlerësuar në mesin e aktorëve rajonal, marrë parasysh kontributin e saj për zhvillimet e fundit për barazi gjinore dhe fuqizim të grave në rajon. Misioni i saj është i bazuar në Rezolutën UNSCR 1325 dhe rezolutat e tjera, si dhe në politikat Evropiane për barazi gjinore.

Gjatë gjithë viteve dhe me mbështetje të vazhdueshme nga UNWOMEN dhe financimin bujar nga Suedia, Norvegjia dhe Finlanda, fokusi i madh i LRG EJL ka qenë në takimet rajonale të nivelit të lartë që përfshijnë gra politikane, femrat udhëheqëse dhe aktivistet për çështjet që lidhen me marginalizimin e grave në lidhje me marrjen e vendimeve për paqe dhe siguri në rajon. LRG EJL ka organizuar edhe disa konferenca rajonale

dhe ndërkombëtare, duke përfshirë: "Gratë në situata pas konfliktit" (2008) në Prishtinë, Kosovë; "Gratë dhe Ndërtimi i paqes në Ballkanin Perëndimor" (2010) në Shkup, Maqedoni; "Qasja në Drejtësi për Gratë në Shtetet Post-konflikteve" (2012) në Zagreb, Kroaci; "Në rrugë për fuqizimin e grave në politikë, proceset e paqes dhe të integritimit në BE", (2014) në Sarandë, Shqipëri; "Fuqizimi i Grave për stabilitetin rajonal", (2015) në Prishtinë, Kosovë. Nëpërmjet këtyre konferencave, qëllimi ishte për të forcuar bashkëpunimin midis grave politike dhe organizatave të grave në nivel kombëtar dhe rajonal; mbështetjen e grave, veçanërisht atyre që kanë pozita me ndikim në komunitetet e tyre, si faktor të paqes dhe pajtimit të cilët mundin si të tilla të ndihmojnë në afrimin e njerëzve së bashku për të mbështetur dialogun në nivele të ndryshme; dhe krijimin e një forumi dinamik, interaktiv dhe krijues të zërave të grave për të mobilizuar mbështetjen dhe angazhimin në një partneritet rajonal me liderët politik gra dhe burra.

Në përputhje me misionin e saj dhe me qëllim për të ofruar kontributin e saj për zgjidhjen e dallimeve dhe mosmarrëveshjeve në proceset politike dhe të paqes, UN WOMEN dhe LRG E.J.L, së bashku me partnerët tjerë të projektit, do të kontribuojë në rritjen e numrit të grave në politikë në nivel kombëtar dhe lokal dhe në proceset e ndërtimit të paqes në mënyrë të përgjegjshme gjinore në BP në përgjithësi. LRG E.J.L synon gjithashtu për ndërtim të partneriteteve më të forta për një botë më të sigurt, me anë të afrimit të përfaqësuesve të grave kryetare nga 7 vende të Ballkanit Perëndimor, gra nga politika, shoqëria civile dhe nga sektori i sigurisë, në një hulumtim të udhëheqësve lokal dhe zhvillim të strategjive të mundshme për parandalim dhe bashkëpunim të përmirësuar.

Ka prova të mjaftueshme për të treguar se pabarazia gjinore e vazhdueshme është një faktor kryesor në parandalimin e progresit drejt arritjes së Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit (OZHM) në lidhje me urinë, varfërinë, shëndetësinë, arsimin, qëndrueshmërinë e mjedisit, dhe luftimin e HIV/AIDS dhe sëmundjeve të tjera. Shumë raporte tregojnë se "progresi është më i ngadalshëm në dimensionet gjinore të këtyre objektivave - nga përmirësimi i shëndetit të nënës dhe qasja në punë të denjë deri tek zhdukja e urisë". Shumica e OZHM-ve janë të varura nga ofrimi i shërbimeve dhe eliminimi i faktorëve që ndihmojnë pengimin e këtyre qëllimeve, veçanërisht i atyre që lidhen me pabarazinë gjinore dhe diskriminimin. Qeveritë lokale janë mjetet kryesore për formulim të ndërhyrjeve, si për të eliminuar pengesat për rezultate të barabarta në kontekste lokale, ashtu edhe për të siguruar barazinë dhe efikasitetin në planifikim, buxhetim, ofrim të shërbimeve dhe mbikëqyrje të qeverisë.

Gjendja e tanishme e grave kryetare të komunave në botë është larg nga pariteti. Gratë ende përbëjnë më pak se 20% të këshilltarëve dhe vetëm 5% të kryetareve të komunave në të gjithë botën, por ka shenja se një brez i ri i liderëve gra është në zhvillim në nivel lokal. Në Ballkanin Perëndimor, situata nuk është shumë më mirë. Ka 4 kryetarët femra në Maqedoni, 3 në Mal të Zi, 4 në Bosnje-Hercegovinë, 10 në Shqipëri, 10 në Kroaci, 3 në Serbi, dhe 1 në Kosovë. Integrimi i perspektivës gjinore në hartimin e politikave lokale është thelbësore për qëllimin tonë të krijimit të barazisë gjinore. Qeveritë lokale janë mjetet kryesore për formulim të ndërhyrjeve, si për të eliminuar pengesat për rezultate të barabarta në kontekste lokale, ashtu dhe për të siguruar barazi dhe efikasitet në planifikim, buxhetim, ofrim të shërbimeve dhe mbikëqyrje të qeverisë.

Në këtë drejtim, UN Women, së bashku me LRG E.J.L-në, janë duke kërkuar të mbajnë një konferencë të përbashkët rajonale, në të cilën gratë në vendimmarrje në nivel lokal dhe gratë liderë të rajonit janë sjellë së bashku për të krijuar dhe inkurajuar një dialog me gratë kryetare të komunave, në angazhim të komunitetit dhe udhëheqësve të shoqërisë civile nga 7 vendet e Ballkanit Perëndimor.

**Qëllimi i Konferencës:**

Qëllimi i Konferencës është që të adresojë çështjet e Gjinisë dhe Ndërtimit të Paqes dhe çështjet e sigurisë në nivel lokal dhe rolin e kryetareve femra si faktor të mundshëm të ndryshimeve rreth temës së barazisë gjinore, fuqizimit politik dhe harmonisë ndëretnike. Konferenca synon gjithashtu të shikon se çfarë mund të bëhet për fuqizimin e grave në vendim-marrjen lokale dhe çfarë mund të bëhet për të fuqizuar qytetet tona nën udhëheqjen e grave. Agjenda e re urbane duhet të feminizon qytetet tona dhe të fuqizon gratë në të gjitha fushat e jetës urbane. Fuqizimi i grave është edhe një qëllim dhe një mjet për zhvillim të qëndrueshëm urban.

Veprimet përcjellëse të drejtuara nga gratë kryetare të komunave dhe të organizatave qytetare në pilot komunat në Kosovë, BeH, Maqedoni dhe Shqipëri do të mbështeten përmes tryezave të rumbullakëta dhe takimeve të drejtpërdrejta me vendimmarrësit në pozita të nivelit të lartë në kuadër të politikës, medias, shoqërisë civile dhe komunitetit ndërkombëtar për të diskutuar rezultatet e çdo konferencë.

#### **Rezultatet e pritura nga tryeza e rumbullakët:**

- Dialogu dhe bashkëpunimi është inkurajuar mes grave kryetare të Ballkanit Perëndimor, grave në politikë, aktivisteve të shoqërisë dhe rrjeteve të shoqërisë civile, si dhe udhëheqëseve lokale për qeverisje demokratike nga rajoni, rreth temës së barazisë gjinore, fuqizimi i tyre politik dhe harmonia ndëretnike.
- Hartë e qartë rrugore për adresimin dhe mbështetjen e grave në vendimmarrje në nivel lokal është rënë dakord mes grave kryetare dhe vendimmarrëseve tjera brenda politikës, shoqërisë civile, medias dhe komunitetit ndërkombëtar nga rajoni i BP.
- Jane zhvilluar mjete të avokimit për rëndësinë e rolit të grave, kontributin në proceset e paqes dhe ndikimin e tij mbi përvojën e grave të sigurisë.
- Deklarata e përbashkët mbi përfundimet dhe rekomandimet kryesore nga Konferenca Rajonale, e cila lidhet me çështjet Gjinore dhe të Ndërtimit të Paqes dhe çështjet e Sigurisë e projektuar për të rritur rolin, ndikimin dhe angazhimin e grave është zhvilluar.
- Deklarata e përbashkët mbi përfundimet dhe rekomandimet kryesore nga Konferenca Rajonale është ndarë në gjithë rrjetin e LRG EJK, qeveritë kombëtare, EU, UN dhe organizatat tjera relevante ndërkombëtare.